



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2018

V E N D I M

Nr. _____, Datë _____/10/2018

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 67, datë 21.05.2018, e Z. A. D., ku pretendohet diskriminim, për shkak të “bindjes politike”¹, nga ana e Z. S. R., Kryeinspektor (i komanduar) pranë Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujrave, Dega Gjirokastër.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Mbështetur në informacionin, që përmban formulari i ankesës, rezulton se Z. A. D. ka filluar punë pranë Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujrave dhe Turizmit, në datën 11.05.2017, në pozicionin e Përgjegjës të Sektorit të Policisë Pyjore Përmet, pranë ISHMPUT-së, Dega Rajonale Gjirokastër. Në vijim, nëpërmjet Urdhërit nr.133, datë 08.06.2017, të Kryeinspektorit të ISHMPUT-së, në nivel qendror, ai transferohet në pozicionin e Inspektorit të Sektorit të Policisë Pyjore Tepelenë, pranë ISHMPUT-së, Dega Rajonale Gjirokastër.

Ankuesi shprehet se fillimisht i është dhënë masë disiplinore nëpërmjet shkresës nr. 165, datë 20.04.2018, të Kryeinspektorit të ISHMPUT-së, Dega Rajonale Gjirokastër për braktisje të aksionit “Të pastrojmë tokën që duam”. Ndërkohë që, në vijim nëpërmjet Urdhërit nr. 209, datë 11.05.2018, të Kryeinspektorit të ISHMPUT-së, në nivel qendror, atij i është dhënë masa disiplinore “vërejtje”, me motivacion “Moskryerje e detyrave duke braktisur aksionin “Pastrojmë

¹ Referuar kartës së anëtarësisë së lëshuar nga Lëvizja Socialiste për Integrim.

² Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën KMD.

tokën që duam””. Ankuesi thekson faktin se i ka kryer detyrat me tepër korrektësi dhe asnjëherë nuk ka braktisur aksionin “Pastrojmë tokën që duam”, por kundërshtimet e tij nuk janë marrë parasysh.

Në vijim, me shkresën nr. 252, datë 17.05.2018, të Kryeinspektorit të ISHMPUT-së, Dega Rajonale Gjirokastrë, i është tërhequr vëmendja për shkak të komunikimit jo korrekt me eprorin, ndërkohë që Z. A. D. pretendon se në datën 17.05.2018, titullari i tij e kishte urdhëruar fillimisht verbalisht, në mënyrë aspak etike, për të shkuar për inspektim në Bashkinë e Tepelenës dhe Memaliaj dhe vetëm më vonë, pas kërkesës së ankuesit, këtij të fundit i është dhënë shkresa që e autorizonte të shkonte në inspektim. Në momentin që ai paraqitet në punë, pas kryerjes së inspektimit, njihet me shkresën nr. 252, datë 17.05.2018, të Kryeinspektorit të ISHMPUT-së, Dega Gjirokastrë, ku i jepet masë disiplinore.

Z. A. D. pretendon se ai i ka kryer me korrektësi të gjitha detyrat e ngarkuara nga eprori, por të gjitha masat disiplinore e marra ndaj tij, kanë ardhur si rrjedhim i diskriminimit që atij po i bëhet për shkak të bindjeve të tij, politike, të cilat janë të ndryshme nga ato të titullarit të tij.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat procedurialë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit të ankesës nr. 67, datë 21.05.2018, e Z. A. D. u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Për këtë arsye, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Nëpërmjet shkresës nr. 713/1, datë 23.05.2018, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, njoftoi Z. S. R., Kryeinspektor (i komanduar) pranë Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Dega Rajonale Gjirokastrë, mbi ankesën e mësipërme, si dhe kërkoi informacion mbi çështjen e parashtruar nga ankuesi. Shkresa iu dërgua për dijeni edhe Z. A. L., Kryeinspektor (i komanduar), pranë Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, në nivel qendror, pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe ankuesit A. D.. Përveç informacionit me shkrim mbi pretendimet e Z. A. D., Komisioneri kërkoi edhe aktet e mëposhtëme:

- Urdhëri i emërimit në detyrë të Z. A. D.;
- Kopje të të gjithë akteve për dhënie masash disiplinore ndaj ankuesit, si dhe relacioneve përkatëse ose procesverbaleve të mbajtura, ku rezultojnë shkeljet e ankuesit;
- Informacion, nëse ankuesi ka paraqitur observacionet e tij për dhënien e masave disiplinore dhe mënyrën se si është reflektuar nga ISHMPUT dega Gjirokastrë dhe

ISHMPUT, në nivel qendror. Bashkëlidhur informacionit u kërkuan të dërgohen kopje të shkresave zyrtare drejtuar ankuesit.

- Informacion mbi faktin, nëse janë dhënë masa disiplinore ndaj inspektorëve të tjerë të ISHMPUT, Dega Rajonale Gjirokastrë, përgjatë së njëjtës periudhë;
- Çdo akt tjetër administrativ, që ka lidhje me çështjen në shqyrtim.

1. Z. S. R., Kryeinspektor (i komanduar) pranë Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Dega Rajonale Gjirokastrë nuk i ktheu përgjigje shkresës nr. 713/1, datë 23.05.2018, së Komisionerit brenda afatit 30 ditor të përcaktuar në pikën 7, neni 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

C. Në vijim, Komisioneri iu drejtua Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Dega Gjirokastrë, me shkresën nr. 713/2 Prot., datë 26.06.2018, nëpërmjet së cilës i bëri kujtesë për të dërguar informacionin e kërkuar brenda datës 03.07.2018.

1. Në përgjigje të shkresës nr. 713/2 Prot., datë 26.06.2018, të Komisionerit, Z. S. R. dërgoi shkresën nr.343/1, datë 05.07.2018, ku dërgoheshin aktet e kërkuara nga Komisioneri, si dhe njoftohej Komisioneri mbi faktin se përgjatë së njëjtës periudhë kohore janë dhënë masa disiplinore për punonjës të tjerë të ISHMPUT Gjirokastrë. Në shkresën e sipërpërmendur nuk parashtroheshin prapësimet e Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Dega Rajonale Gjirokastrë, lidhur me pretendimet e ankuesit, si dhe nuk jepej informacion mbi faktin, se si ishte reflektuar mbi observacionet e ankuesit ndaj masave disiplinore të dhëna ndaj tij.

D. Në datën 12.07.2018, strukturat përgjegjëse të Komisionerit u njoftuan nga ankuesi A. D., se nëpërmjet shkresës nr. 3548 Prot, datë 10.07.2018, të ISHMPUT, në nivel qendror, ankuesi është njoftuar për zgjidhje të marrëdhënieve të punës. Shkresa në fjalë ishte mbështetur në shkresën nr. 378 Prot., datë 03.07.2018, të ISHMPUT, Dega Rajonale Gjirokastrë, ku bëhej propozim për largim nga puna të Z. A. D..

E. Në këto kushte, nëpërmjet shkresës nr. 713/4, datë 13.07.2018, drejtuar Z. A. L., Kryeinspektor (i komanduar) i ISHMPUT-së, në nivel qendror dhe Z. S. R., Kryeinspektor pranë ISHMPUT-së, Dega Rajonale Gjirokastrë, Komisioneri kërkoi informacion mbi çështjen në fjalë, brenda datës 17.07.2018, si dhe informon mbi faktin se në referencë të nenit 15, pika 2³, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në asnjë rast institucionet publike, apo subjektet private nuk mund të ndërpresin marrëdhëniet e punës me punonjësin, gjatë kohës që ankesa e tij është duke u shqyrtuar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

³ Neni 15, pika 2 e ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi parashikon: “Gjatë periudhës së shqyrtimit të ankesës, punëmarrësi ka të drejtë të vazhdojë punën sipas kushteve të kontratës.”

1. Z. A. L., Kryeinspektor (i komanduar) i ISHMPUT-së dhe Z. S. R., Kryeinspektor pranë ISHMPUT-së, Dega Gjirokastrë nuk i dërguan përgjigje shkresës nr. 713/4, datë 13.07.2018, së Komisionerit.
 2. Në këto kushte, strukturat përkatëse të Komisionerit kontaktuan telefonikisht me Z. S. R., Kryeinspektor (i komanduar) pranë ISHMPUT-së, Dega Gjirokastrë dhe i kërkuan informacionin sipas shkresës nr. 713/4, datë 13.07.2018.
 3. Në përgjigje të shkresës nr.713/4, datë 13.07.2018, së Komisionerit, Z. S. R., Kryeinspektor (i komanduar) pranë ISHMPUT-së dërgoi shkresën nr. 713/4, datë 06.08.2018, nëpërmjet së cilës e bën me dije Komisionerin, se ndaj Z. A. D. ka nisur procedura për ndërprerje të marrëdhënieve të punës nga ana e ISHMPUT, Dega Rajonale Gjirokastrë duke bërë propozim për largim nga detyra pranë ISHMPUT-së, në Nivel Qendror. Kjo procedurë ka nisur e bazuar në fakte të pakundërshtueshme që i janë paraqitur ISHMPUT-së, në Nivel Qendror, duke e faktuar me dokumenta shkresore, që Z. A. D. nuk ka zbatuar rregullat e etikës në komunikim me eprorin, nuk ka kryer detyrat e ngarkuara për muajin qershor 2018 dhe nuk ka zbatuar rekomandimet e Auditit të Brendshëm të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit. Bashkëlidhur shkresës së sipërpërmendur, u dërguan aktet përkatëse mbi masat disiplinore që i janë dhënë Z. A. D.
- F.** Në vijim të procedurave hetimore, nëpërmjet shkresës nr.1140, datë 14.08.2018 “Njoftim për seancë dëgjimore”, Komisioneri iu drejtua palëve në proces, ku i njoftoi për pjesëmarrje në seancën dëgjimore, që do të zhvillohej në datën 22.08.2018, ora 13:00, pranë Zyrës së Komisionerit.

Në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 22.08.2018, mori pjesë vetëm Znj. B. B., përfaqësuese e Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujrave dhe Turizmit, ndërkohë që ankuesi dhe përfaqësuesi i Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujrave dhe Turizmit, Dega Rajonale Gjirokastrë ishin në mungesë.

Znj. B. B. u shpreh në seancë se mbështetur në ankesat e njëpasnjëshme të bëra nga punonjësit e ISHMPUT-së, Dega Rajonale Gjirokastrë, Z. S. R. i ishte tërhequr vëmendja, lidhur me faktin se duke qënë në pozicionin e Kryeinspektorit të ISHMPUT-së, Dega Rajonale Gjirokastrë nuk kishte vendimmarrje për dhënie masash disiplinore. Njëkohësisht, Znj. Braho u shpreh se masa e propozuar nga Z. S. R. për Z. A. D., nëpërmjet shkresës nr.378. Datë 03.07.2018, nuk është marrë parasysh dhe ankuesi është ende në punë. Ndër të tjera, ajo u shpreh se është marrë vendim që masat disiplinore të marra nga Z. S. R., të jenë të pavlefshme. E pyetur nga Komisioneri, nëse ankuesi është njoftuar për sa më sipër, Znj. B. B. u shpreh se ankuesi është njohur me procesverbalin e mbajtur pas seancës dëgjimore, të zhvilluar pranë ISHMPUT-së, Tiranë, në datën 13.07.2018, si dhe në vijim Z. A. D. i është dërguar shkresa që ai do të jetë ende në punë. Komisioneri kërkoi që shkresat që kanë shfuqizuar masat disiplinore të ankuesit në fjalë

të dërgohen pranë KMD-së, duke e konsideruar që lidhur me ankesën e Z. A. D. është arritur qëllimi, për të cilin është filluar hetimi administrativ.

G. Në kushtet kur, në ditët në vijim ISHPMUT, në nivel qendror nuk i dërgoi aktet e kërkuara nga Komisioneri, nëpërmjet së cilave shfuqizoheshin masat disiplinore të dhëna ndaj ankuesit A. D., strukturat përgjegjëse të KMD-së komunikuan me telefon me Znj. Braho, e cila u shpreh se Z. S. R. kishte kaluar në pozicionin e inspektorit pranë ISHPMUT-së, Dega Rajonale Gjirokastër dhe ankuesi vazhdonte ende të ishte në detyrë, por ISHPMUT, në nivel qendror nuk kishte nxjerrë asnjë akt nëpërmjet, së cilit të shfuqizoheshin masat disiplinore të mëparshme të Z. A. D.. Strukturat përgjegjëse të KMD-së i kërkuan të gjitha aktet që ishin nxjerrë në lidhje me çështjen konkrete dhe në vijim Znj. Braho dërgoi me e-mailin e datës 13.09.2018, shkresën nr. 378, datë 03.07.2018, të Z. S. R., Kryeinspektor i ISHPMUT-së, Dega Rajonale Gjirokastër, nëpërmjet së cilës propozohej masë disiplinore “largim nga puna” për Z. A. D., si dhe shkresën nr. 3350, datë 04.07.2018, të ISHPMUT-së, Tiranë, nëpërmjet së cilës Z. S. R. i tërhiqej vëmendja.

H. Ankuesi A. D. u njoh me sa më sipër dhe nëpërmjet e-mailit të datës 20.09.2018, kërkoi që Komisioneri të vazhdonte procedurën e shqyrtimit administrativ të ankesës së tij dhe të shprehej mbi diskriminimin e pretenduar, pasi masat disiplinore të dhëna ndaj tij ishin ende në fuqi.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, të cilat bëjnë pjesë në kompetencat, që atij i atribuon ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

A. Lidhur me trajtimin e pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Turizmit është institucion qendror publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për mjedisin dhe funksionon në bazë të Vendimit nr. 103, datë 04.02.2015, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve” (i ndryshuar) dhe Rregullores së Brendshme nr. 1, datë 15.09.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave në nivel qendror dhe nivel vendor”.

Me Urdhërin nr. 103, datë 11.05.2017, të Kryeinspektorit të ISHMPUT, në nivel qendror, Z. A. D. është emëruar me detyrë Përgjegjës i Sektorit Përmet, në Sektorin e Policisë Pyjore pranë ISHMPUT-së, Dega Rajonale Gjirokastër. Në vijim, nëpërmjet Urdhërit nr. 133, datë 08.06.2017, të Kryeinspektorit të ISHMPUT, në nivel qendror, ai transferohet në pozicionin e

Inspektorit të Sektorit të Policisë Pyjore Tepelenë, pranë ISHMPUT-së Dega Rajonale Gjirokastër.

Kryeinspektori (i komanduar në detyrë), pranë ISHMPUT-së, Dega Rajonale Gjirokastër, nëpërmjet shkresës nr. 165, datë 20.04.2018, jep masë disiplinore “vërejtje”, me motivacion “*moskryerje e detyrave duke braktisur aksionin “pastrojmë tokën që duam”*” për 10 (dhjetë) inspektorë të ISHMPUT, Dega Rajonale Gjirokastër, përkatësisht për inspektorët, S. Z., A.D., B.S., L.A., Y.S., E.P., E.K., T. G., S.R., A.S, ndër të cilët edhe për inspektorin A. D.. Në vijim, nëpërmjet Urdhërit nr. 209, datë 11.05.2018, Kryeinspektori i ISHMPUT, në nivel qendror, i jep Z. A. D., masën disiplinore “vërejtje”, me motivacion “*moskryerje e detyrave duke braktisur aksionin “pastrojmë tokën që duam”*”. Nëpërmjet Memos nr. 250, datë 17.05.2018, Z. A. D. i është drejtuar Z. A. L., Kryeinspektor (i komanduar në detyrë), pranë ISHMPUT-së, në nivel qendror dhe Z. S. R., Kryeinspektor (i komanduar në detyrë) i ISHMPUT, Dega Rajonale Gjirokastër, ku shprehen kundërshtimet dhe sqarimet e tij, në lidhje me masën e marrë. Pavarësisht memos së dërguar nga ankuesi, asnjë prej Kryeinspektorëve të sipërpërmendur, nuk i kthen përgjigje Z. A. D..

Në vijim, sërisht në datën 17.05.2018, Z. A. D. i jepet masa disiplinore “tërheqje vëmendjeje”⁴, nga ana e eprorit të tij, direkt, Z. S. R., Kryeinspektor i ISHMPUT, Dega Rajonale Gjirokastër. Motivacioni i masës së dhënë është “*komunikim jo korrekt me eprorin*”. Z. A. D. e informon me e-mail Kryeinspektorin e ISHMPUT në nivel qendror, mbi këtë masë të dhënë ndaj tij, duke theksuar faktin se është dërguar për inspektim në Tepelenë, fillimisht nëpërmjet një urdhëri verbal nga ana e eprorit të tij direkt, Z. S. R. dhe në vijim pas kërkesës së ankuesit, i është vënë në dispozicion autorizimi për inspektim. Pas kthimit të tij në punë, në të njëjtën ditë, Z. A. D. është informuar mbi këtë masë disiplinore që i është dhënë nga eprori direkt. Pavarësisht e-mailit të dërguar nga Z. A. D. në adresë të ISHMPUT, në Nivel Qendror, ky institucion nuk pati asnjë reagim zyrtar mbi çështjen e parashtruar nga ankuesi.

Për sa më sipër, gjatë analizimit të dispozitave përkatëse të Vendimit nr. 103, datë 04.02.2015, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve” (i ndryshuar) dhe Rregullores së Brendshme nr. 1, datë 15.09.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave në nivel qendror dhe nivel vendor” rezulton se nuk ka asnjë parashikim specifik dhe të qartë, lidhur me çështjen e dhënies së masave disiplinore për punonjësit e ISHMPUT-së, në nivel qendror apo edhe në degët rajonale. Pas kontaktimit telefonik me strukturat përkatëse të Sektorit të Burimeve Njerëzore, pranë ISHMPUT-së, në nivel qendror, ato pohuan të njëjtat konstatime të Komisionerit, por theksuan faktin se dhënia e masave disiplinore është tagër e Kryeinspektorit të ISHMPUT-së, në Nivel Qendror, pas marrjes së propozimit për masë disiplinore nga ana e Kryeinspektorit të ISHMPUT-së në nivel vendor. Kjo, në interpretim të zgjeruar të pikës 6, gërma a), të Vendimit nr. 103, datë 04.02.2015, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve” (i

⁴ Masa disiplinore i është dhënë nëpërmjet shkresës nr. 252, datë 17.05.2018, të Z. S. R., Kryeinspektor i ISHMPUT, Dega Rajonale Gjirokastër.

ndryshuar), ku përcaktohet: “.....*ISHMPUT-ja në nivel qendror është përgjegjëse për të gjithë institucionin, përfshirë dhe degët në nivel rajonal, për kryerjen e këtyre funksioneve të brendshme: a) menaxhimin e burimeve njerëzore, si dhe ndjekjen e çështjeve ligjore, të teknologjisë së informacionit, të mirëmbajtjes dhe shërbimeve të tjera mbështetëse”. Ndërkohë që, roli propozues në dhënien e masave disiplinore i Kryeinspektorit në nivel rajonal, parashikohet sërish në interpretim të zgjeruar të pikës 11, të Vendimit të sipërpërmendur, ku parashikohet: “*Degët rajonale të ISHMPUT-së drejtohen nga drejtuesi i degës rajonale. Drejtuesi i degës rajonale përfaqëson degën rajonale në marrëdhënie me të tretët, në nivelin e qarkut përkatës dhe është përgjegjës për organizimin dhe bashkërendimin e punës për funksionimin, cilësinë dhe efektivitetin e veprimtarisë së tij*”.*

Ndërkohë që, pretendimi i Z. A. D. për diskriminim për shkak të bindjeve politike, po shqyrtohej pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në datën 10.07.2018, nëpërmjet shkresës nr. 3548, datë 10.07.2018, të Kryeinspektorit (të komanduar në detyrë), pranë ISHMPUT-së në nivel qendror, ankuesi njoftohet për zgjidhje të marrëdhënieve të punës. Referuar shkresës në fjalë, zgjidhja e marrëdhënieve të punës ka ardhur si pasojë e moskryerjes së detyrave sipas procedurave ligjore. Shkresa nr. 3548, datë 10.07.2018, e Kryeinspektorit A. L. është e mbështetur në shkresën nr. 378, datë 03.07.2018, me lëndë “Propozim për largim nga detyra”, të Kryeinspektorit të ISHMPUT-së, Dega Rajonale Gjirokastrë. Ndër të tjera, ankuesi njoftohet se duhet të paraqitet në një seancë bisedimesh, në të cilën do të parashtrihen arsyet e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës dhe atyre financiare, si dhe për të shprehur kundërshtimet e tij mbi këtë proces. Seanca dëgjimore u realizua në datën 17.07.2018, në zyrën e Njësisë së Burimeve Njerëzore, ISHMPUT-së, në nivel qendror.

Për sa më sipër, Komisioneri faktin që nuk është reaguar ndaj observacioneve të parashtruara nga ankuesi mbi 2 (dy) masat e para disiplinore të dhëna ndaj tij, është fakt që dëshmon për ekspozimin e Z. A. D., ndaj një qëndrimi të padrejtë e disfavorizues, nga ana e Kryeinspektorit të ISHMPUT-së, Dega Rajonale Gjirokastrë dhe Kryeinspektorit të ISHMPUT-së, në nivel qendror, në kundërshtim me nenin 37, paragrafi 2, i ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), ku parashikohet shprehimisht: “*Procedura e shqyrtimit të masës disiplinore nga punëdhënësi duhet të garantojë të drejtën e punëmarrësit për t’u dëgjuar, mbrojtur, parashtruar fakte dhe prova brenda një afati të arsyeshëm*”. Asnjë nga të drejtat e punëmarrësit nuk janë zbatuar në rastin e Z. A. D., për dy masat e para disiplinore të dhëna ndaj tij.

Njëkohësisht, fakt që provon për një qëndrim të padrejtë ndaj Z. A. D. është edhe dhënia e masave disiplinore ndaj tij, nga ana e Kryeinspektorit të ISHMPUT-së, Dega Rajonale Gjirokastrë, pa patur asnjë kompetencë për të dhënë masa disiplinore ndaj inspektorëve në varësi të tij. Në bazë të interpretimit të pikave 6/a dhe 11 të Vendimit nr. 103, datë 04.02.2015, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve” (i ndryshuar), kompetenca për dhënie masash disiplinore i njihet vetëm Kryeinspektorit të ISHMPUT-së, në nivel qendror. Ndërkohë që, nëse i referohemi shkresës nr. 165, datë 20.04.2018 dhe shkresës nr. 252, datë 17.05.2018, së Z. S. R.,

Kryeinspektor i ISHMPUT, Dega Rajonale Gjirokastrë, rezulton se Z. A. D. i janë dhënë masa disiplinore “vërejtje” dhe tërheqje vëmendjeje”.

Në shkresën nr. 3350, datë 04.07.2018, e ISHPMUT-së, në nivel qendror, Z. S. R. i tërhiqet vëmendje, pasi ai nuk ka të drejtë vendimmarrjeje për dhënie masash disiplinore ndaj inspektorëve, që ka patur në varësi, ndërkohë që Kryeinspektori ISHPMUT-së, në nivel qendror nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të shpallur pavlefshmërinë e tyre. Në referencë të nenit 109, gërma a), të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, aktet e nxjerra nga Z. S. R., në mungesë të kompetencës ligjore, konsiderohen të paligjshme. Në rastet të tilla zbatohen parashikimet e nenit 110, gërma b) të ligjit të sipërpërmendur, ISHPMUT, në nivel qendror, në cilësinë e organit epror, duhet të kishte shpallur pavlefshmërinë absolute të akteve të sipërpërmendura.

Pavarësisht sa më sipër, ISHMPUT, në nivel qendror, mbështetur në ankesat e punonjësve të ISHMPUT, Dega Rajonale Gjirokastrë, ka kryer verifikimet përkatëse dhe ka marrë masa ndaj Z. S. R., duke i tërhequr vëmendje dhe duke e ulur në detyrë. Ndërkohë që masa e fundit disiplinore e propozuar ndaj Z. A. D., nga ana e Z. S. R. nuk është zbatuar dhe ankuesi punon ende në pozicionin e tij të punës.

Për sa më sipër, referuar nenit 7, pika 1, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”⁵, Komisioneri gjykon se Z. A. D. i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, dhe disfavorizues, nga ana ISHPMUT-së, Dega Rajonale Gjirokastrë.

B. Shkaku i mbrojtur.

Ankuesi pretendon se diskriminohet për shkak të bindjes politike nga ana e Kryeinspektorit të ISHPMUT, Dega Gjirokastrë.

“*Bindja politike*” është një prej shkaqeve, për të cilat, Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

I. “Bindja politike” konsiderohet si shkak i mbrojtur, sepse parashikohet shprehimisht si i tillë në nenin 1, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, si dhe

⁵ Neni 7, pika 1, i ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi parashikon: “ Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

ankuesi ka depozituar në cilësinë e provës, kartën e anëtarësisë nr. 17720, datë 08.09.2016, lëshuar nga “Lëvizja Socialiste për Integrim”, e cila vërteton përkatësinë e tij në këtë parti politike.

A. Lidhja e trajtimit të padrejtë dhe disfavorizues me shkakun e mbrojtur.

1. Lidhja e trajtimit të padrejtë dhe disfavorizues me bindjen politike të ankuesit.

Mbështetur në faktet dhe provat e administruara, gjatë procesit të hetimit administrativ të ankesës rezulton se Z. A. D. është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të disfavorshëm, nga ana e ISHPMUT-së, Dega Rajonale Gjirokastër. Komisioneri vlerëson se nga ana e punëdhënësit, ISHMPUT, Dega Rajonale Gjirokastër nuk u depozituan argumenta dhe prova për të hedhur poshtë pretendimin e ankuesit, se dhënia e disa masave disiplinore të njëpasnjëshme ndaj tij, nuk ka ardhur si pasojë e bindjes së tij politike.

Neni 82, pikat 2 dhe 3 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar)⁶ ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në rastin konkret ISHMPUT, Dega Rajonale Gjirokastër. Pra, në këtë rast, ISHMPUT, Dega Rajonale Gjirokastër, duket të provonte se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe më pak të favorshme, për shkak të bindjeve politike.

Referuar parashikimit ligjor të sipërpërmendur, ISHMPUT, Dega Rajonale Gjirokastër duhet të depozitonte prova dhe parashtrime që të provonin të kundërtën e pretendimeve të ankuesit, ndërkohë që ky institucion nuk ka arritur të argumentojë qëllimin e ligjshëm të dhënies së masave disiplinore të njëpasnjëshme ndaj Z. A. D.

Nisur nga shqyrtimi i fakteve të sipërpërmendura, Komisioneri gjykon se veprimet apo mos veprimet e ndërmarra nga ana e ISHMPUT, Dega Rajonale Gjirokastër, në dëm të ankuesit kanë sjellë si pasojë pozicionimin e tij në kushte të disfavorshme.

Në mbështetje të parashikimeve të nenit 3, pika 1 dhe 7, pika 1, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri vlerëson se Z. A. D. është ekspozuar ndaj një trajtimi të pafavorshëm dhe diskriminues nga ana e ISHMPUT, Dega Rajonale Gjirokastër, trajtim i cili ka lidhje me bindjen politike të ankuesit.

PËR KËTO ARSYE :

⁶ Neni 82, pikat 2 dhe 3, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar) parashikon: “2. Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj. 3. Në mënyrë që të mbështesin pretendimet e tyre, palët mund t’i bashkëlidhin kërkesës për fillimin e procedurës administrative dokumente ose fakte të ndryshme.”

Mbështetur në në nenin 18, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 17, 109-110, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 9 dhe nenin 37, paragrafi 2, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), nenin 1, nenin 3, pika 1, nenin 7, pika 1, nenet 12-13, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pika 10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e diskriminimit të Z. A. D., për shkak të bindjeve politike, nga ana e ISHPMUT-së, Dega Rajonale Gjirokastrë.
2. Të merren masa të menjëherëshme nga ana e ISHPMUT-së, Dega Rajonale Gjirokastrë ose ISHPMUT-së, në nivel qendror, për shpalljen e pavlefshmërisë absolute të masave disiplinore të dhëna, nga ana e Z. S. R., ish-Kryeinspektor, pranë ISHPMUT-së, Dega Rajonale Gjirokastrë, ndaj Z. A. D..
3. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, ISHPMUT, në nivel qendror dhe ISHPMUT-së, Dega Rajonale Gjirokastrë, të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

(shkak – bindja politike
Fusha-punesim)